

**Njoftimi i përqendrimit me të cilin MERKATOR-CG D.O.O. Podgorica, Mali i Zi, do të fitoj kontroll mbi biznesin e shitjes me pakicë të FRANCA MARKETI SHPK Bijelo Pole Mali i Zi**

**(lënda nr. 08-150/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 11.11.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin shoqëria **MERKATOR-CG D.O.O. Podgoricë** (MERCATOR-CG D.O.O. Podgorica), me seli në rrugën Put Radomira Ivanovica nr. 2, Podgoricë, Mali i Zi, synon të fitoj kontrollin e vetëm mbi shoqërinë e sapoformuar për qëllime veçanta (SHQV) e cila do të marrë përsipër biznesin me pakicë të **FRANCA MARKETI DOO Bijelo Pole**, (FRANCA MARKETI DOO Bijelo Polje), me seli në rr. Svetog Petra Cetinjskog BB Bijelo Pole, Mali i Zi. Transaksioni i propozuar i referohet blerjes së biznesit me pakicë të **FRANCA MARKETI DOO Bijelo Pole**, për qëllimin e të cilit ortakët e Franca Marketi, anëtarët e familjes Franca (Hilmija Franca, Hatema Franca, Sead Franca, Safet Franca, Halid Franca dhe Halida Franca) do të themelojnë një shoqëri për qëllim të veçantë ("SHQV") të cilës do t'i transferohet biznesi me pakicë të Franca Marketi dhe më pas Merkator-CG do të blejë 100% të pjesëve në SHQV.

Biznesi i shitjes me pakicë që përfaqëson mjetet e synuara përbëhet nga:

- (i) pajisja që e përdor Franca Marketi për të drejtuar biznesin e saj të shitjes me pakicë;
- (ii) rezerva totale e mallit të shitjes me pakicë që e posedon Franca Marketi;
- (iii) punonjës që kryejnë detyra operative në dyqanet me pakicë të Franca Marketi;
- (iv) gudvill gjegjësisht vullnet i mirë (goodwill).

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

Aktiviteti i regjistruar i **Merkator-CG** është 4719 – Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara.

**Merkator-CG** është pjesë e **Grupit Fortenova**, aktiviteti kryesor i të cilit është shitja me pakicë e mallrave të përditshme të destinuara për konsum të gjerë tek konsumatorët përfundimtarë përmes një rrjeti dyqanesh me pakicë në Slloveni, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi.

Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime **MERKATOR MACEDONIA SHPKNJP Shkup**, me seli në Ognjen Prica 1/3-28 kat i ndërmjetëm, Shkup, Kisella Vodë, Maqedonia e Veriut (në tekstin e mëtejshëm: "**Merkator MK**") është shoqëri e varur e Fortenova Group e regjistruar Maqedoninë e veriut, e cila merret me tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht me ushqime, pije dhe duhan, por nuk është më aktive në tregti.

Aktiviteti i regjistruar i Franca Marketi është 4729 - tregti tjetër me pakicë e ushqimeve në dyqane të specializuara.

Parashtruesi konsideron se si tregje relevante të produkteve mund të definohet *tregu i tregtisë me pakicë jo të specializuar të produkteve ushqimore dhe mallrave për konsum të përgjithshëm*.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email:*

*kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

15.11. 2022

Shkup